



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komunikatë

26.07.2013

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas miratimit të tri raporteve nga mbledhjet e kaluara dhe agjendës së mbledhjes, ka shqyrtuar dhe miratuar disa nga aktivitetet me prioritet. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, e ka informuar KQZ-në se, subjekti politik “Serpska Demokratska Stranka Kosova i Metohija”, në kuvendin e saj të VI –të zgjedhor, ka marrë vendim që ta ndryshoj emrin, në: “Social Demokratija (DS). KQZ, e ka aprovuar kërkesën e këtij subjekti për ndryshimin e emrit. Gjithashtu, më 27 qershor 2013, Iniciativa politike “Partia Tradicionale Shqiptare ” kryetar i të cilës është z. Sali Salihu, ka dorëzuar aplikacionin për regjistrim. Por, ZRPP mendon se, programi politik i kësaj initiative bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pasi që ka dëgjuar rekomandimin e Zyres, me tetë (8) vota për, një (1) votë kundër, dhe një (1) abstenim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, e ka miratuar rekomandimin e ZRPP-së për mos regjistrim të Iniciativës Politike – Partia Tradicionale Shqiptare-PTSH.

Zyra, e ka informuar KQZ-në se, më 23 korrik 2013, ka aplikur për certifikim një iniciativë qytetare për Kuvendin e Obiliqit, e quajtur “Gradjanska Iniciativa Buduqnost”, me përfaqësues Predrag Joviq.

Në vazhdim të mbledhjes, Kryeshefi i SKQZ-së, z. Enis Halimi, e informuar KQZ-në për afatet kohore të zbatimi të Planit Operacional. Njësia e Shërbimit të Votuesve, ka mbajtur trajnimin lidhur me Rregullat Zgjedhore, të cilat kanë pësuar ndryshime, siç janë: Rregulla Zgjedhore Nr. 02/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Rregulla Zgjedhore Nr. 04/2013 Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta, dhe Rregulla Zgjedhore nr. 17/2013 Periudha e Shërbimit të Votuesve për Ndërrimin e Qendrës së Votimit. Gjithashtu, po bëhen edhe përgatitjet e programit për trajnimin orientues për Anëtarëve të Komisioneve Komunale Zgjedhore. Njësia e Shërbimit të Votuesve, e ka përgatitur materialin për prezantim që ka të bëjë me Shërbimin Votues, gjegjësisht me krijimin e Listës së Votuesve, duke përfshirë Periudhën e Shërbimit të Votuesve për ndërrimin e Qendrave të Votimit (QV), dhe Periudhën e Sfidimit dhe të Kundërshtimit të Listës së Votuesve, krijimin e Listës së Votuesve jashtë Kosovës, Periudhën e Regjistrimit dhe të Votimit, të Votuesve me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta, Regjistrimin e Votuesve të Ngjuar në Shtëpi, të Votuesve në Institucione dhe të Votuesit në Rrethana të Veçanta. Njësia e Shërbimit të Votuesve në kuadër të përgatitjeve për Operacionin e Votimit përmes Postës, ka bërë shtypjen e formularëve për regjistrim/ aplikim nga jashtë Kosovës. Në kuadër të informimit të votuesve jashtë vendit janë instaluar linjat telefonike me qasje ndërkombëtare dhe gjithashtu janë ri-aktivizuar email-at zyrtarë të Operacionit të Votimit përmes Postës. Janë bërë të gjitha përgatitjet për nënshkrimin e kontratës për Shërbimet postare, gjegjësisht dërgesave postare në mes të SKQZ, si porosites i shërbimeve dhe PTK-së si kryes i shërbimeve.

Në kudër të OVPP-së, gjegjësisht e Periudhës së Regjistrimit, që fillon me datë 27.07.2013, po bëhen përgatitjet teknike lidhur me organizimin e zyrës, vendosjen e pajisjeve që nevojiten për fillimin e aktiviteteve në kuadër të Njesisë së Operacionit të Votimit Jashtë Kosovës. Në bazën e të dhënave, po

bëhet azhurimi i tabelave të kthyer nga terreni për çdo qendër votimi, bashkimi i votuesve manual me ata automatik, ndaraja e votuesve nëpër qendrat split, vlerësimi i kapaciteteve për çdo qendër votimi, Përpunimi i databazës për votim jashtë vendit, Shqyrtimi i bazës së të dhënave për votimin përmes postës dhe Shtypja e fletës njoftuese për secilin votues për votim jashtë vendit. Po ashtu, po përgatiten edhe specifikat për Fletëvotimet me rekomandimet dhe vërejtjet që kanë dalë nga KOZ-i, Dizajnet e Broshurave dhe të Fletëvotimeve. Po përgatitet e ri-dizajnimi i kartelës për vëzhgues dhe po bëhet freskimi i Ueb faqes me lajme, vendime si dhe me materiale të tjera nga njësitë e SKQZ-së.

Këshilli për Operacione Zgjedhore, e informoi KQZ-në me shqyrtimi i specifikave teknike të fletëvotimeve për Zgjedhjet Lokale 2013. Fletëvotimet, kanë të bëjnë me kandidatët për Kryetar Komune, dhe me kandidatët për anëtar të Asambleve Komunale. Alban Krasniqi, kryesues i KOZ-it, ka thënë se, janë shqyrtuar specifikat dhe janë sjellë edhe ndryshimet. Është ndërhyrë në sasinë e fletëvotimeve, dhe nga një milion e tetqind mijë, janë zbritur minus pesdhjet mijë ! Gjithashtu, edhe vendvotimet. Janë paraparë rreth 2700 vendvotime, por kjo nuk nënkupton që nuk do të ketë ndryshime. Te raundi i dytë, janë paraparë 1.5 milion fletëvotime në rast se do të ketë balotazh, duke marrë parasysh edhe përvojat e kalaura. KQZ, i miratoi specifikat teknike, dizajnin dhe formatin e Fletëvotimeve për Zgjedhjet Lokale 2013. *KQZ, kërkoi nga SKQ që në specifikat për shtypjen e Fletëvotimeve për Zgjedhjet Lokale 2013, të vendosen tri kritere të sigurisë. Gjithashtu, në bazë të aktiviteteve për përgatitjen e zgjedhjeve, KQZ i shqyrtoi edhe specifikat dhe dizajnin e Distinktivit për KVV-të për zgjedhjet.*

Sipas raportit të KOZ-it, gjatë kësaj mbledhje, KQZ shqyrtoi nominimet për anëtar të KKZ-ve nga Subjektet Politike, sipas komunave: Laposaviq, Obiliq, Zubin Potok, Zveçan, Hani Elezit, Graçanicë, Ranilluk, Klllokot, Mitrovica e veriut, Glllogoc, Gjilan, Dragash, Kamenicë, Mamushë. Pas shqyrtimit, KQZ emëroi dymbëdhjetë (12) anëtarë të Komisioneve Komunale Zgjedhore të për këto komuna. Gjithashtu, KQZ shqyrtoi dhe miratoi rekomandimet për tri zëvendësime të asambleistëve nga komuna e Dragashit. KQZ, miratoi këto zëvendësime: Fair Kasami, zëvendësohet me Mahir Dautin nga subjekti politik ‘PDK’, Majlinda Pirkuqi-Halili, zëvendësohet me Vehbi Rexhepin nga subjekti politik ‘LDK’, Arian Maliqi, zëvendësohet me Valon Halilin nga subjekti politik ‘LVV’, Besnik Muçaj, zëvendësohet me Fatmir Tiplicën nga subjekti politik, ‘AAK’.

Në vazhdim të mbledhjes, Nexhmedin Hyseni, Koordinator i terrenit, e informoi KQZ-në lidhur me emërimin e katër anëtarëve të KKZ-ve sipas komunave: Glllogoc, Gjilan, Kamenicë dhe Suharekë. Shqyrtimi ka pasur të bëjë nëse këta anëtar, janë ose jo, subjekte të hetimit nga Prokuroria. Në fund, KQZ e ka refuzuar rekomandimin e Këshillit të Operacioneve Zgjedhore të KQZ-së për emërimin e këtyre anëtarëve për Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) për Zgjedhjet 2013, sipas kërkesave të subjekteve politike, si në vijim: 1. Blerim Ilazi, i nominuar nga subjekti politik ‘LVV’ në Glllogoc, Fatos Kuqi, i nominuar nga subjekti politik ‘AAK’ në Suharekë, Blerim Muji, i nominuar nga subjekti politik ‘LDK’ në Gjilan, dhe Xhevat Ramadani, i nominuar nga subjekti politik ‘LDK’ në Kamenicë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve